

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Mikrobiologjia e përgjithshme
Niveli:	Mjekësi Veterinare
Statusi lëndës:	Obligativë
Viti i studimeve:	Viti II ^{të} ; semestri III-të
Numri i orëve në javë:	2+2 (30+30)
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Driton Sylejmani Prof. Dr. Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Departamenti i Veterinarisë.
Detajet kontaktuese:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Laboratori i Mikrobiologjisë
Përshkrimi i lëndës	
	Ky kurs hyrës tenton të udhëheq studentët në aspektin e lëndës së Mikrobiologjisë në aspektin gjeneral, evolucionin e mikroorganizmave dhe generacionin spontan. Më pas ofron njohuri në të kuptuarit e mikroorganizmave në natyrë dhe klasifikimin e tyre si mikroorganizma eukariot, prokariot dhe acelulare, me ndërtimin qelizore, të ushqyerit e mikroorganizmave, metabolizmin dhe rritjen e mikroorganizmave. Ndryshueshmëria e mikroorganizmave do të jetë një tjetër çështje me rëndësi ku do të sqarohet, etj.
Qëllimet e lëndës:	Kursi i mikrobiologjisë ka për qëllim të rrisë njohuritë tek studentët në këtë lëndë në bazat e të kuptuarit të lëndës së mikrobiologjisë në Mjekësinë Veterinare sidomos në relacionet ndërmjet ushqimit të kafshëve, fermës (kafshëve) dhe bartja e infeksioneve në njerëz si dhe produktet e kafshëve. Me detalisht do të sqarohet proceset e evoluimit të mikroorganizmave, ndryshueshmërinë e mikroorganizmave, dallueshmëritë ndërmjet grupeve dhe llojeve të mikroorganizmave të ndryshëm. Poashtu do të mësohet se si mund të paraqesim lakoren e rritjes së mikroorganizmave si faktor me rëndësi studiuës.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë,

	<p>shkathësitë dhe kompetencat si në vijim:</p> <p>Njohuritë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të arrijnë të njohin mikroorganizmat, morfologjinë, identifikimin dhe funksionet tjera të tyre - Të kenë njohuri mbi faktorët abiotik dhe biotik në raport me mikroorganizmat - Të njohin karakteristikat e baktereve, kërpudhave dhe virusëve me interes veterinar <p>Shkathësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të arrijnë përmes shkathësive të fituara gjatë realizimit të lëndës të njohin rolin e mikroorganizmave në mjekësinë veterinare sidomos si shkaktarë të sëmundjeve mikrobiale në kafshë - Të arrijnë të përdorin teknikat kryesore laboratorike mikrobiologjike në identifikimin e baktereve dhe kërpudhave, të virusëve si dhe të jenë të aftë në demonstrimin e metodave të ndryshme diagnostikuese <p>Kompetencat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të arrijnë që me kompetencë dhe përgjegjësi ti aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara qoftë në aspektin teorik dhe atë praktik gjatë këtij kursi duke iu shërbyer në vitet e ardhshme studimore si dhe në drejtim të ngritjes së tij profesionale - Të kenë përgjegjësi gjatë kryerjes së detyrave studimore apo profesionale si dhe aftësi bashkëpunuese me të tjerët.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me	1	12	12

mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Koha e kaluar ne vleresim (kolokiume, seminare, provim)	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	23	23
Përgaditja përfundimtare për provim	1	23	23
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Ligjërata Konsultime Puna praktike apo laboratorike Puna individuale dhe prezentimet nga studentet Angazhime tjera.</i>		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Praktika • Kolokfiume • Provimi përfundimtar 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Veterinary Microbiology. Third edition by: D. Scott McVey, Melissa Kennedy, M. M. Chengappa. Publisher: Wiley-Blackwell; 3 edition (August 5, 2013). ISBN-13: 978-0470959497 (2013). - Mikrobiologjia e përgjithshme. Pranvera Çabeli Kusi, Vasil Tola. Universiteti Bujqësor i Tiranës. Tiranë, 2003. 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Essential Microbiology, 2nd Edition by Stuart Hogg ISBN 978-1-119-97891. Publisher: Wiley-Blackwell Hardcover (2013). 		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Hyrje në mikrobiologji Roli i studimit të mikrobiologjisë në Mjekësinë Veterinare		
Java e dytë:	Struktura qelizore e mikroorganizmave dhe funksioni i tyre Funksioni i organeleve qelizore Principet biokimike		
Java e tretë	Të ushqyerit e mikroorganizmave, rritja dhe metabolizmi		

	Të ushqyerit e mikroorganizmave dhe kultivimi
Java e katërt:	Të ushqyerit e mikroorganizmave, rritja dhe metabolizmi II Rritja e mikroorganizmave Metabolizmi i mikroorganizmave
Java e pestë	Fiziologjia e mikroorganizmave
Java e gjashtë:	Faktorët që ndikojnë në rritjen dhe mbijetesën e mikroorganizmave në ushqim të kafshëve dhe fermë Faktorët biotik dhe abiotik
Java e shtatë:	Faktorët që ndikojnë në rritjen dhe mbijetesën e mikroorganizmave në ushqim të kafshëve dhe fermë Bazat ushqyese pH dhe kapaciteti ushqyes Redoks potenciali mikrobik Aktiviteti i ujit
Java e tetë:	Diversiteti i mikroorganizmave: Kërpudhat Bakteriet
Java e nëntë:	Diversiteti mikrobik II Virusët, Bakteriofaget; Algat.
Java e dhjetë:	Diversiteti mikrobik III-Protozoaret; Myqet
Java e njëmbëdhjetë:	Ndryshueshmëria dhe gjenetika e mikroorganizmave Ndryshueshmëria e mikroorganizmave Mikroorganizmat në gjenetiken ingjinierike
Java e dymbëdhjetë:	Efekti antimikrobial dhe kemioterapia: aspekti general Antibiotiket: përparësit dhe mangësit në mjeksinë veterinare
Java e trembëdhjetë:	Metodat tradicionale dhe molekulare që përdoren në mikrobiologji Metodat tradicionale Numrimi i përgjithshëm i mikroorganizmave Testet serologjike Metodat molekulare ADN/ARN
Java e katërmëdhjetë:	Sterilizimi dhe metodat e sterilizimit.
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezentimi i seminareve
Java	Ushtrimet që do të zhvillohen
Java e parë:	Hyrje në mikrobiologji. Njohja me temat e ushtrimeve që do të zhvillohen.
Java e dytë:	Mikroskopi, funksioni dhe pjesët e mikroskopit.
Java e tretë	Përgatitja e preparative mikroskopike. Metoda e përgatitjes së preparateve native.
Java e katërt:	Metoda e përgatitjes së preparateve të ngjyrosura,

Java e pestë	Ngjyrat mikrobiologjike, Përgatitja e preparateve për ngjyrosje
Java e gjashtë:	Preparatet e fiksuara të ngjyrosura
Java e shtatë:	Ngjyrosja e thjeshtë. Ngjyrosja e përbër. Ngjyrosja sipas Gramit.
Java e tetë:	Ngjyrosja e sporeve të baktereve
Java e nëntë:	Ngjyrosja e kapsulave të baktereve
Java e dhjetë:	Sterilizimi. Metodat e sterilizimit.
Java e njëmbëdhjetë:	Përgatitja e terreneve ushqyese
Java e dymbëdhjetë:	Testi i Antibigramës
Java e trembëdhjetë:	Metoda tradicionale e numrimit të përgjithshëm të mikroorganizmave
Java e katërbëdhjetë:	Realizimi i një testi serologjik
Java e pesëmbëdhjetë:	Metodat molekulare PCR, ELISA testi

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja e studenteve e ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Reflektimi në punë në grupe është i dëshirueshëm.